

V E N D I M
Nr. 186, datë 3.5.2002

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 68, DATË 15.2.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE DHE TË KUSHTEVE TEKNIKE TË
PROJEKTIMIT DHE TË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të nenit 18 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe të nenit 17 të ligjit nr. 8464, datë 11.3.1999 "Për standardizimin", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në lidhjen nr. 1 të pikës 1 të vendimit nr. 68, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 28, me këtë përmbajtje:

"28. S SHEN 10080:1999

Çeliku për armaturat e betonit. Çeliku i vjaskuar, i saldueshëm, B500, për armaturat e betonit".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko